



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Anglishte Biznesi

Ngarkesa: 4 kredite, 40 seminare, 0 leksione
Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti II, Sem II
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor ne Gjuhe Angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndorë : Të aftësojë studentët për të përdorur gjuhën angleze në kontekstin e biznesit, në mënyrë funksionale dhe të sigurt. Të përmirësojë kompetencat gjuhësore të studentëve në të katër aftësitë (të folurit, të dëgjuarit, leximin dhe të shkruarit) për qëllime profesionale. Të zhvillojë ndërgjegjësimin dhe kompetencat ndërkulturore, të domosdoshme në komunikimin ndërkombëtar të biznesit. Të rrisë vetëbesimin e studentëve në përdorimin e gjuhës në situata reale të fushës së biznesit dhe marketingut.

Objektivat specifike lëndorë:

1. Të mësojnë dhe përdorin terminologji specifike të biznesit në kontekste të ndryshme profesionale.
2. Të ushtrojnë përdorimin e strukturave gjuhësore të nivelit B1-B2 në situata të zakonshme dhe të veçanta të komunikimit në biznes.
3. Të përvetësojnë gjuhën e reklamës, promovimit, dhe marrëdhënieve me klientët.
4. Të mësojnë të kërkojnë dhe japin këshilla, udhëzime dhe informacione relevante në kontekstin profesional.

Rezultatet e të nxënit: Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Shprehen me gojë dhe me shkrim për tema që lidhen me fushën e biznesit.
2. Kërkojnë dhe japin këshilla, drejtime dhe udhëzime në kontekstin e biznesit.
3. Kontaktojnë dhe komunikojnë me klientë në mënyrë të qartë dhe të efektshme.
4. Përdorin saktë strukturat gramatikore të nivelit B1-B2 në situata komunikimi profesional.
5. Lexojnë, kuptojnë dhe interpretojnë tekste nga fusha e biznesit.